



TAKIMI I 34 I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ENERGISË PËR MESDHEUN

01 Dhjetor 2022, Cairo, Egjipt

Në datën 1 dhjetor u zhvillua Asambleja e Përgjithshme e 34 e shoqatës së Rregullatorëve të Mesdheut, Medreg, nën mikpritjen e Regullatorit Egjiptian të Gazit GasReg. Kjo Asamble u hap me fjalën e Presidentit të MEDREG, z. Petrit Ahmeti, gjatë së cilës ai i uroi mirëseradhjen të ftuarve dhe më pas i la fjalën Kryetarit të GasReg dhe ZV President i Medreg z. Karem Mahmoud. Asamblenë gjithashtu e përshëndeti dhe Ministri Egjiptian i Energjisë.

Kryetarët e Grupeve të punës bënë një përmbledhje të aktiviteteve të grupeve për periudhën nga Asambleja e fundit e qershorit 2022.

Po ashtu në këtë Asamble, u diskutua mbi bashkëpunimin e shoqatës së Rregullatorëve të Mesdheut, me aktorët e tjerë si ECRB, CEER, ICEER, UfM, OME etj, si dhe mbi buxhetin dhe kontratën grant të financimit nga ana e BE-së për vitet 2023-2025.

Pas mbarimit të suksesshëm të mandatit dy vjeçar të z. Ahmeti si kryetar i Medreg, si dhe përfundimit të mandatit si nënkryetare e Grupit të punës së Konsumatorit të komisioneres së ERE znj. Erjola Sadushi, në këtë asamble u zgjodhën nga anëtarët, përfaqësuesit e strukturave të larta drejtuese për 2 vjecarin e ardhshëm si dhe kryetarët dhe zv kryetarët e grupeve të punës dhe Task Forcave.

Është kënaqësi e nder, që përfaqësues të ERE zgjidhen për dy vjecarin e ardhshëm të marrin pjesë në nivele të larta drejtuese të strukturave të kësaj organizate të rëndësishme. Komisionerja e ERE Znj.Sadushi është zgjedhur të mbajë pozicionin e zv. kryetares së Grupit të punës së Konsumatorëve dhe Sekretarit të Përgjithshëm të ERE, z.Elton Radheshi, i është besuar kryesimi në bashkëpunim me Sekretariatit të Task Forcës së bashkëpunimit me platformat e UfM.

Presidenti i ardhëm i MEDREG për periudhën 2022-2024, u zgjodh Z. Abdellatif Bardach, Presidenti aktual i Autoritetit Rregullator të Energjisë të Marokut (ANRE), i cili gjatë fjalës së tij prezantuese pasi falenderoi z.Ahmeti për punën e shkëlqyer dhe arritjet e Medreg gjatë këtyre dy viteve vuri theksin në sfidat e reja të sektorit dhe rolin që Medreg mund dhe duhet të luajë në tranzicionin energjetik të vendeve.

Z.Ahmeti në fjalën e tij pasi falenderoi rregullatorët pjesmarrës në suportin e dhënë përgjatë presidencës së tij, i uroi Presidentit të ri suksese në detyrën e tij dhe shprehu suportin e ERE-s në këtë shoqatë dhe në të ardhmen.

Asambleja e ardhshme do të zhvillohet në Greqi në Qershor të vitit 2023.